

UDHËZIM
Nr. 253, datë 10.4.2020

**PËR MENAXHIMIN E RASTEVE TË FËMIJËVE NË NEVOJË PËR MBROJTJE
GJATË PERIUdhËS SË FATKEQËSISË NATYRORE, PËR ARSYE TË
EPIDEMISË SË SHKAKTUAR NGA COVID-19**

Në mbështetje të pikës 5, të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 2, të nenit 42 dhe të nenit 53, të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”; të nenit 24, të ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; të germës “a”, të pikës 6.1, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 24.3.2020, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”; të nenit 5, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 578, datë 3.10.2018, “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”,

UDHËZOJ:

KREU I
TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i procedurave dhe i veprimeve konkrete të strukturave të mbrojtjes së fëmijës, për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

2. Strukturat e mbrojtjes së fëmijës, mbështesin, ndërgjegjësojnë, informojnë fëmijët dhe familjet e tyre, rreth situatës së krijuar nga epidemia e shkaktuar nga COVID-19, për masat parandaluese, shenjat dhe simptomat për identifikimin e sëmundjes, rrugët e referimit të strukturat shëndetësore, numrat e emergjencës dhe si të aksesojnë shërbimet e ofruara, në territorin ku jetojnë.

3. Strukturat e mbrojtjes së fëmijëve për realizimin e detyrave të përcaktuara në pikën 2, përshtatin aktivitetet e tyre për grupet e cënueshme mbi COVID-19, nëpërmjet komunikimit me telefon apo mënyrave të tjera të komunikimit në distancë. Punonjësit duhet t’u përmbahen protokolleve të rrepta për COVID-19, si: distancimi shoqëror, përdorimi i mjeteve mbrojtëse dhe i masave të tjera higjieno-sanitare.

4. Strukturat e mbrojtjes së fëmijës sigurohen që fëmijët marrin informacionin e nevojshëm lidhur me COVID-19, nëpërmjet mënyrave të duhura të komunikimit, në përputhje me zhvillimin, moshën, gjininë, kulturën e tyre dhe situatën familjare në të cilën ndodhen.

5. Punonjësit e mbrojtjes së fëmijës të pajisen me mjetet e nevojshme të mbrojtjes individuale, të pajisen me leje qarkullimi nga policia për të lëvizur në çdo orar, si dhe t’u sigurohet logjistika e nevojshme për të realizuar vizitat në shtëpi.

KREU II

REFERIMI TË SHËRBIMET SHËNDETËSORE, SHOQËRORE DHE PSIKOLOGJIKE

1. Punonjësit e mbrojtjes së fëmijës, në bashki ose njësi administrative, bashkëpunojnë me strukturat e shëndetit dhe strukturat operationale të sistemit të mbrojtjes civile, për përditësimin e informacionit lidhur me evidentimin dhe trajtimin e rasteve të dyshuara me COVID-19 në territorin e tyre.

2. Punonjësit e mbrojtjes së fëmijës, në bashki ose njësi administrative, bashkëpunojnë në mënyrë aktive me punonjësit e shëndetit, psikologët e shkollave për referimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, si dhe rasteve kur fëmija mbetet pa kujdes prindëror, për arsye se

prindi/kujdestari ligjor shtrohen në spital apo humbasin jetën si rezultat i epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

3. Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës në bashki ka për detyrë të mbështesë punonjësën për mbrojtjen e fëmijës në nivel njësie administrative, për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, si dhe ta informojë lidhur me shërbimet shëndetësore, shoqërore dhe psikologjike, që ofrohen nga strukturat shtetërore apo aktorët e shoqërisë civile, në territorin e tyre.

4. Punonjësit e mbrojtjes së fëmijës në bashki ose njësi administrative, për rastet që kanë nevojë për mbështetje psikologjike, i referojnë ato pranë shërbimeve që ofrojnë mbështetje psikologjike në distancë, si:

a) linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë ALO 116 111 – duke telefonuar te numri pa pagesë: 116 111;

b) këshillimi *online* në platformën: www.nukjvetem.al. Platforma ofron këshillim nëpërmjet mesazheve ose ofron terapi individuale nëpërmjet shërbimit *chat*;

c) psikologët e shkollave respektive të fëmijëve për këshillim *online*. Punonjësit e mbrojtjes së fëmijës duhet që, në çdo rast, të disponojnë numrat e psikologëve të shkollave në njësinë përkatëse ku operojnë;

ç) shërbimin që ofron Urdhri i Psikologut nëpërmjet “Psikologët shqiptarë *online*”, i cili ka publikuar në faqen zyrtare listat e psikologëve, në dispozicion për t’u përgjigjur qytetarëve.

KREU III

MENAXHIMI I RASTEVE TË FËMIJËVE NË NEVOJË, PËR MBROJTJE GJATË PERIUdhËS SË FATKEQËSISË NATYRORE

1. Menaxhimi i rasteve të reja të fëmijëve në nevojë për mbrojtje nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, në bashki ose njësi administrative, bëhet në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në ligjin 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 578, datë 3.10.2018, “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, duke mbajtur parasysht si më poshtë vijon:

a) rastet e fëmijëve në nevojë, për mbrojtje me rrezik të ulët, do të menaxhohen nëpërmjet telefonit;

b) për rastet e fëmijëve në nevojë, për mbrojtje me rrezik të mesëm dhe të lartë, në rastet kur nuk ka asnjë tregues për COVID-19 në familje apo komunitet, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës realizon vizita në familje, duke pasur parasysht respektimin e protokolleve të rrepta për COVID-19, si: distancimi shoqëror, përdorimi i mjeteve mbrojtëse dhe i masave të tjera higjieno-sanitare.

c) për rastet e fëmijëve në nevojë, për mbrojtje me rrezik të mesëm dhe të lartë, kur ka konfirmim të COVID-19 në familje apo komunitet, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës komunikon nëpërmjet telefonit, për t’u siguruar që fëmija dhe familja janë në rregull. Punonjësit e mbrojtjes së fëmijës, menjëherë, në bashkëpunim me strukturat shëndetësore dhe të policisë, si dhe duke ndjekur protokollin e përcaktuara tashmë në urdhrin e ministrit të shëndetësisë, marrin masa për vendosjen e fëmijës në një shërbim alternativ.

2. Strukturat e mbrojtjes së fëmijëve tregojnë vëmendje të veçantë për trajtimin, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 578, datë 3.10.2018, “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, të rasteve të fëmijëve:

a) pa kujdes prindëror, që janë të ndarë nga prindërit/kujdestarët e tyre, për arsye të sëmundjes, duke përfshirë fëmijët në qendra izolimi/emergjenca, qendra trajtimi apo përkujdesjeje alternative;

b) prindërit/kujdestarët e të cilëve janë të sëmurë, të karantinuar, shtruar në spital ose kanë vdekur, në rastet e COVID-19;

c) në situatë rruge;

ç) të izoluar në shtëpi që nuk kanë akses në shërbime, si fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët me sëmundje kronike;

d) të prekur nga sëmundja COVID-19, të cilët mund të mos pranohen nga familjet e tyre dhe/ose komuniteti;

dh) të cilët kanë anëtarë të familjes të prekur nga COVID-19, që nuk mund të kujdesen për fëmijën;

e) të dhunuar dhe të neglizhuar nga anëtarët e familjes, të cilët, për shkak të masave të izolimit, janë edhe më të rrezikuar se më parë;

ë) migrantë apo azilkërkues të pashoqëruar apo të ndarë nga prindërit e tyre.

3. Për kategoritë e fëmijëve të përcaktuara, për sa më sipër, strukturat e shëndetësisë kanë detyrimin ligjor për të raportuar pranë punonjësve të mbrojtjes së fëmijës rastet e identifikuara.

4. Nëse punonjësi i mbrojtjes së fëmijës dyshon se ka ndonjë nga simptomat e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, ai/ajo nuk duhet të largohet nga banesa. Në këtë rast, punonjësi informon menjëherë me shkrim ose rrugë elektronike eprorin dhe Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës. Drejtori i Strukturës së Shërbimeve Shoqërore në bashki merr masa për të caktuar një punonjës tjetër nga struktura e shërbimeve shoqërore, i cili do të menaxhojë rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

5. Punonjësit e mbrojtjes së fëmijës rishikojnë dosjet e tyre ekzistuese, për t'u siguruar që vlerësimi i nivelit të rrezikut është i përshtatshëm gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, për arsye të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, si dhe në kushtet e distancimit social.

6. Gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore nuk do të realizohen mbledhjet e Grupit Teknik Ndërsektorial. Gjatë kësaj periudhe anëtarët e Grupit Teknik Ndërsektorial do të vijojnë komunikimin në rrugë të tjera alternative, si: telefon, *email*, *video call*. Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës dokumenton diskutimin dhe mendimet e anëtarëve të grupit, si dhe e dërgon atë me *email* tek anëtarët e tjerë të grupit.

KREU IV MASAT E MBROJTJES

1. Gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, masat e mbrojtjes merren nga punonjësit e mbrojtjes së fëmijës dhe konfirmohen me *email* nga drejtuesi i strukturës së shërbimeve shoqërore në bashki. Këto masa mbeten të vlefshme gjatë gjithë periudhës, në të cilën gjykatat në vend kanë pezulluar punën dhe nuk kanë filluar shqyrtimin e tyre apo deri në daljen e një udhëzimi tjetër apo shfuqizimin e këtij udhëzimi.

2. Bashkitë, në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror, identifikojnë shërbimet e emergjencës për mbrojtjen e fëmijës, si dhe çdo shërbim tjetër për mbrojtjen e fëmijës gjatë situatës së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19. Lista e shërbimeve të emergjencës dhe shërbimeve të tjera për mbrojtjen e fëmijës, numrat e kontaktit përkatës, u komunikohen të gjithë punonjësve të mbrojtjes së fëmijës në bashki dhe njësi administrative. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës publikon në faqen zyrtare listën e shërbimeve të emergjencës në nivel kombëtar ose rajonal.

3. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, me mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile mundëson ngritjen e një ose me shumë shërbimeve tranzitore, për mbrojtjen e fëmijëve gjatë periudhës së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

4. Në rast të një fëmije në nevojë për mbrojtje emergjente (duke përfshirë këtu edhe rastet e fëmijëve pa kujdes prindëror, për arsye se prindi/kujdestari janë shtruar në spital, për arsye të infeksionit të shkaktuar nga COVID-19), punonjësi i mbrojtjes së fëmijës merr masën e mbrojtjes emergjente dhe e referon fëmijën pranë shërbimit të emergjencës. Në çdo rast, para

referimit në shërbimet e strehimit emergjent, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës merr informacion të detajuar për fëmijën dhe anëtarët e tjerë të familjes, lidhur me mundësinë që fëmija ose anëtarët e tjerë të familjes të jenë të infektuar nga COVID-19.

5. Gjatë menaxhimit të rastit për zbatimin e masës emergjente të mbrojtjes dhe të masës për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative, punonjësit e mbrojtjes së fëmijës kontaktojnë Shërbimin Kombëtar të Urgjencës për të siguruar transportin e sigurt me ambulancë të fëmijëve drejt institucionit të përkujdesjes shoqërore rezidenciale ose shërbimit të emergjencës.

6. Institucionet e përkujdesjes shoqërore rezidenciale marrin të gjitha masat për përcaktimin e një hapësire të posaçme për karantinimin e fëmijëve që janë brenda institucionit dhe shfaqin shenjat e COVID-19, por edhe për fëmijët të cilët vendosen në institucion me masë mbrojtje, deri në momentin e daljes së rezultateve pas testimit të tyre. Gjatë periudhës së karantinës fëmija mbikëqyret nga personeli shëndetësor dhe nga një punonjës social, të cilët janë të pranishëm gjatë gjithë kohës, për të mbështetur fëmijën dhe për të parandaluar përhapjen e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19. Fëmija qëndron në izolim, nën përkujdesje gjatë gjithë kohës që ai/ajo është e infektuar nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19.

7. Për fëmijët, ndaj të cilëve merret masa e mbrojtjes për vendosjen e tyre në përkujdesje alternative, në institucion të përkujdesjes shoqërore rezidenciale, Instituti i Shëndetit Publik, pas referimit që i bën Shërbimi Social Shtetëror, mundëson brenda 48 orësh testimin e tyre për COVID-19. Fëmija qëndron në hapësirën e posaçme për karantinimin përpara dhe gjatë kohës që kryhet testimi. Në rast se fëmija rezulton pozitiv ndaj testit, ai vazhdon të qëndrojë në hapësirën e posaçme për karantinim të krijuar brenda institucionit të përkujdesjes shoqërore rezidenciale. Nëse pas testimit fëmija rezulton negativ, ai mund të qëndrojë në hapësirat e përbashkëta me fëmijët e tjerë. Fëmija kryen edhe ekzaminimet e tjera shëndetësore, sipas procedurave të vendosjes së fëmijëve në institucionet rezidenciale.

8. Fëmijët më aftësi të kufizuara, ndaj të cilëve merret masa emergjente e mbrojtjes ose masa e mbrojtjes për vendosjen e tyre në përkujdesje alternative, do të vendosen në institucione të përkujdesjes shoqërore për këto grupe përfituesish, duke i ofruar shërbim psikosocial dhe shërbim të specializuar, duke respektuar procedurat e përcaktuara në pikën 3 dhe 6 të këtij kreu.

9. Për fëmijët e prekur nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19, të cilët pranohen në spital, për shkak të COVID-19, ngarkohet shërbimi psikosocial në qendrat spitalore, për ofrimin e mbështetjes psikologjike të fëmijëve, si edhe nëse lejohet edhe kujdestarët ligjorë, gjithashtu, qëndrojnë në spital bashkë me fëmijët.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, Shërbimi Social Shtetëror, Instituti i Shëndetit Publik, strukturat e mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor.

2. Ky udhëzim është i vlefshëm deri në përfundimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, për shkak të epidemisë të shkaktuar nga COVID-19.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu